



EDITORIALI

A e bleu Qeveria KQZ-në?

Miratimi i procedurës së kundërligjshme (siç e quajten vetë para pak ditësh zyrtarët e Ministrisë së Financave) të kërkesave buxhetore të Komisionit Qendror Zgjedhor për mëditje dhe bonuse ishte vetëm njëri nga sinjalet konkrete për çështjen e fletëvotimeve. Duke e përmbushur oreksin për ca euro më shumë të anëtarëve të KQZ-së, Ekzekutivi i vendit duket se ia lehtësoi vetes punën kundër presionit të Serbisë për neutralitet ndaj statusit në ditën e votimeve. Alternativa për ta joshur pakicën serbe që të dalë më 3 nëntor në zgjedhjet lokale edhe në pjesën veriore të vendit, është heqja e logos Republika e Kosovës nga fletëvotimet. Kryeministri Hashim Thaçi me deklaratat e tij në mbledhjen e Qeverisë la të kuptohej diçka, por edhe e shtoi konfuzionin. Ndonëse pak ditë më herët ai kishte thënë se kjo është punë e KQZ-së, si institucion i pavarur, të premtën, me një gjuhë lakonike, ua bëri me dije anëtarëve të komisionit, partive dhe opinionit publik se në fletëvotime do të ketë logo të pranueshme për të gjithë, por që "nuk do të duartrokitet". Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, po hesht pas deklaratës së Thaçit, duke dëshmuar edhe një herë se është totalisht nën instruksionet e politikës. Problemi këtu nuk është ndoshta thjesht vetëm të heqja eventuale e logos, por te procesi zgjedhor në tërësi. Dyshimet janë të forta se në votime mund të ketë sërish manipulime. KQZ-ja e politizuar po na bind për çdo ditë e më shumë se është në gjendje t'i mbyllë sytë para shkeljeve të ndryshme, para urdhrave të politikës, duke rënë kështu në kundërshtim me Kushtetutën. Jo rastësisht edhe ambasadori britanik Klif e theksoi në intervistën për gazetën "Kosova Sot" se KQZ-ja është politizuar së tepërmi dhe duhet të reformohet. Reforma mbetet detyrë që mund të kryhet nëse ka vullnet politik, pas zgjedhjeve lokale, sepse tani nuk ka më kohë. Një KQZ e paanshme dhe e pavarur i adreson me përgjegjësi e kompetencë temat si ajo e logos e plot çështje të tjera të rëndësishme për zgjedhje të lira me standarde ndërkombëtare.

INTERVISTË ME AMBASADORIN E BRITANISË SË MADHE NË KOSOVË, IAN KLIF (2)

Investitorët nuk i besojnë Gjyqësorit kosovar

Ministritë në dijeni për dy-tri raste të kompanive britanike



"Në Kosovë ka shumë rëndësi forcimi i sundimit të ligjit, sidomos në fushën e investimeve dhe respektimit të kontratave, sepse është e evidente që ekziston një mungesë në këtë drejtim dhe një mungesë e besimit të investitorëve në lidhje me mundësinë e marrjes së vendimeve të drejta", thotë ambasadori britanik **5**

MILIONAT E PRIVATIZIMIT NË KOSOVË



Fondi i AKP-së, 60 milionë për bankat

Mjetet do të investohen në formë të depozitave. Ekspertët e ekonomisë nuk janë shumë entuziastë për vendimin e bordit të AKP-së, ndërsa kritikojnë zvarritjen e kontesteve në privatizim **6**



Mustafa sërish kandidat për Prishtinën **4**



PERGATITJET PËR ZGJEDHJET E 3 NENTORIT
Vonohet Lista e votuesve **2**



NJE OPERACION I RRALLE NE KALIFORNI
Një 63-vjeçari i hiqet tumori 90 kilogramësh **34**



LEXUESIT THONE SE "KOSOVA SOT" ESHTË EMER I MADH NE GAZETARINE TONE
Osmanaj, fitues i një tepihu; Bacaj pushim në Shqipëri **14**

Festo Fito
Loja e madhe shpërblyese
15.000 shpërblime

Festoni 15-vjetorin e gazetës "Kosova Sot"
KOSOVA SOT
E PËRDITSHME INFORMATIVE E PAVARUR
15 VJET

FITUESIT E LOJËS SHPËRBLYESE "LEJO DHE FITO" DUHET TË LAJMËROHEN NGA E HËNA DERI TË SHTUNËN NË TELEFONIN: 038 601 330, NGA ORA 10:00 -16:00, DITËN E NJËJTË, APO MË SË LARGU TË NESËRËMEN.

ANALIZË LIBRI

RETROSPEKTIVAT E NJË DITARI TË RËNDËSISHËM POETIK

SHKRUAN:
DR. GJEKË
MARINAJ

Shefqet Dibrani dhe "Anatomia e brymës" janë në akord të plotë konceptimi jo vetëm mes tyre si entitete gubinike, por edhe me mëdyshjen e përhënor nëse kjo është koha e duhur për botimin e një antologjie me poezi të zgjedhura nga krijimtaria e tij e deritanishme.


Titulli i antologjisë "Anatomia e brymës", ngaqë ra fjala, është i rëndësishëm se përputhet me historinë e autorit në planin akademik, ngaqë Anatomia ka qenë pjesë integrale e studimeve të tij universitare në Degën Biologji-Kimi.

PESHA E POEZISË SË AUTORIT

Për t'i perceptuar këto imazhe jetike në përmasat reale të poezisë së Dibranit, i cili i ka observuar nga afër, me trishtimin e një nxënësi të klasës së dytë të shkollës fillore demonstratat e Prishtinës të vitit 1968, do ia vlen të përpiqemi t'i kapërcëjmë grabutat e përqendrimet dhe konvergencën gjatë kohës së kaluar me këtë libër. Pësja e poezisë në "Anatomia e brymës" qëndron mbi dy kolona kryesore, njëra shqetësohet për fatet dhe fatalitetet e mërgimit dhe tjetra përqendrohet kryesisht në dashurinë dhe dhembjen për njeriun shqiptar. Nëse depërtojmë me qëllimin dhe kuriozitetin e duhur në këto thellësi sa metaforike aq edhe reale, do shohim se titujt e librave prej të cilave kam zgjedhur këto poezi: Larg pikon hëna (1994); Pse e urrej Kadarenë (1996); Ditar mërgimi (1998); Strehët e gjakut (2000); Ëndërr e njëjtë, tokë tjetër (2007) janë më optimiste në përberje se sa në plastikë. Kjo do të thotë se esenca e këtij libri nuk është një trysni qarqesh apokaliptike që poeti i jep lexuesit, por një galaktikë imazhesh dhe zërash që tentojnë të mbajnë gjallë ndjenjën e mbijetesës së kombit tonë bazuar në besimin të njeriu dhe të drejtë e tij për të jetuar një jetë të lirë dhe sa më të lumtur. Po ta analizojmë me kujdesin që meriton këtë platformë kuptimplotë në hapësirën poetike të Dibranit, e ritheksoj se është e domosdoshme që prurja e tij në letërsinë shqipe të shihet më parë në planin kontekstual e pastaj, nëse dikush e sheh si të domosdoshme, të trajtohet si pjesë e rrymave letrare sipas sferave të preferencave të secilit lexues. Kjo për vetë faktin se Dibrani dhe poezia e kompozuar prej tij kanë lindur dhe janë rritur në etnet e një atmosfere sfinkse kur pesimizimi i udhës së njerëzimit gjithandë, por veçanërisht në Kosovë, sidomos gjatë luftës së fundit, mori përmasa ndër më alarmantet në historinë e këtij populli.

KONOTACIONET E EMRIT "GJYQ" DHE FOLJES "GJYKOJ"

Konceptet intelektuale të këtij soj simbolizmi kanë pasur vlera afatgjate në të mirë të proceseve letrare të Dibranit, sepse kanë shtrirë bazamentin për një përsiatje të një krijimtaria natyrale që e ka lejuar të imagjinojnë përtej motiveve

(Shefqet Dibrani:
"ANATOMIA E BRYMËS", poezi e zgjedhur, botoi "Fak Konica", Prishtinë 2013)

të ulëta të disa individëve pa e kompromentuar rrjedhën e normave të moralit të tij personal e kombëtar. Këto rëndomësi ai i ka klasifikuar nën domethëniet e fjalës "gjyq". Konotacionet e emrit "gjyq" dhe foljes "gjykoj", si entitete praktike të një procesi gjyqësor, në këtë antologji marrin një rëndësi shumë më kolatike se sa roli i tyre në trupëzimin gjuhësor apo funksionimin lingvistik të fjalës. Mjafton t'u referohemi poezive "Në gjyq", "Fjala e lirë" apo "Gjyq në Zürich" për ta ndërjet trysinë e turbulencës ligjore kur fjala e lirë konfrontohet nga pengesa serioze gjatë ecourisë së saj si dhe për të mësuar rrethanat që quan poetin deri aty. Poezitë e kësaj teme na fusin në qendrën e një qaraku kohor prej pesë vitesh, duke filluar nga viti 1998, kur nisi procesi gjyqësor kundra poetit, në Cyrih, e deri në vitin 2004 kur u mbyll jip proces me shpalljen e pajfajësisë së poetit. Përshtypja më e madhe që na lënë poezitë e kësaj teme, sillet rreth faktit se Dibrani i dramatison seancat dhe konkluzionet e këtij qyqi me të njëjtin qëllim konstruktiv që kishin edhe kritikët e tij ndaj atyre që e denoncuan atë: implementimin e fjalës së lirë dhe konstruktive në të mirë të njerëzimit. Ndaj dy nga aspektet karakteristike të librit "Anatomia e brymës" mbeten miqësia dhe mënyra e përzgjedhjes së saj. Ndonëse poezitë e shumta që u dedikohen gruas, Fehmi Agani, Vajzë, Donikës; djalit, Dibranit; prindërve, vëllezërve dhe motrave tregojnë se poeti beson se miqësia më e sinqertë fillon nga dashuria për familjen, ai paraqitet gjithmonë i hapur për një miqësi të pastër edhe me të takuarit rastit. Nga ana tjetër, vargjet e tij na japin arsye të besojmë se ai e para-seleksionon rrethin shoqëror duke u

20

vlet nga vdekja e Agim Spahiu, i vëllai i Agimit e vlerësorun e Dibranit, duke e sponsorizuar të plotë botimin e këtij libri.

bazuar në vlerat e tyre morale dhe kontributin që i japin shoqërisë me punën dhe veprat e tyre. Të parën e kemi të evidentuar si në ndihmesën që i jep familjes duke sakrificuar

gjihtëka për mirëqenien e tyre ashtu edhe në vetëmohimin e tij për shoqërinë. Për këtë të fundit, mjafton t'u referohemi poezive të titit "ditari" në retrospektivë, ku autori që në fëmijëri ka

qenë pjesëmarrës në demonstratat e shumta të vendit të tij, duke përfshirë këtu, pranverën Kosovare 1981, atë të grevave të minatorëve dhe protestave qytetare të Kosovës në 1989-ën, apo pjesëmarrjen e tij, në forma të ndryshme, në luftën e Kosovës, në të cilën humbi edhe jetën babai i tij. Por jo vetëm të atin. Së bashku me miqtë e shumë intelektuale të vrrarë gjatë së njëjtës kohë kanë qenë edhe Fehmi Agani, Enver Maloku, Xhemal Mustafa, Agim Ramadani e shumë e shumë të tjerë të cilët i gjejmë si pjesë e baladave apo poezive me temë nga Lufta e Kosovës, apo vuajtjet si pasojë e saj.

FRYMËZIMI NGA VIZITA NË SHQIPËRI

Impulset e dashurisë njerëzore për këtë emra të rëndësishëm në jetën dhe kujtimet e Dibranit janë të plotfuqishme në depërtime të tyre tek vetëdija jonë. Të dytën e kemi të dokumentuar në poezitë e frymëzuara nga vizita e parë e tij në Shqipëri në dhjetor të vitit 1992. Me gjithë kohën e kufizuar, ajo i ka shërbyer dëshirës së tij për t'u njohur më njerëz që e kishin vërtetuar veten si personalitete me peshë në kulturën tonë. Ndër këto rrethana ai fitoi miqësinë me Agim Spahiu, Adem Istrefin, Dhimitër Xhuvanin, Xheahir Spahiu, Frederik Reshpen, Dhimitër Shuteriqin, Lazër Stanin, Zija Çelën, Bardhyl London etj. Bashkëpunimi i mëvonshëm me ta dhe miq të tjerë si Azem Shkreli, Ali Podrimja, Rifat Kukaj, Rrahman Deda, Din Mehmeti e Murat Isaku, mund të themi se janë bërë pjesë e një rrjeti të çuditshëm fishes poetike që japin jetë në kulturën kombëtare përmes veprave dhe aktivitetëve të Dibranit në letërsinë bashkëkohore shqipe. Ndërsa miqësia e tij me ministrin aktual të Kulturës së Shqipërisë Visar Zhtin, me poetin e njohur kosovar Adem Istrefi, me shkrimtarin dhe botuesin Nazim Rrahmani (të cilit i kushtohet ky libër), pastaj me Shaip Emërllahun e Ahmet Selmanin, apo me poeteshat Flutura Açka e Mirela Sula nga Tirana e Sevdiqe Rexhepi nga Gjilani i Kosovës, është intensifikuar dukshëm. Por miqësia e Dibranit me poetin kuskian Agim Spahiu pat marrë veçanërisht dimensione kolatike. Menjëherë pas vdekjes tragjike të Spahiut në vitin 1993, Dibrani botoi dhe promovoi me shpenzimet e veta një përmblidhje me poezi të zgjedhura nga Agim Spahiu. Në atë promovim pat marrë pjesë edhe Dr. Ibrahim Rugova me një përsëndetje personale. Veprimet e Dibranit përkuar me mendimet e Miguel de Cervantes-it që thoshte se "ai që humb pasuri humb shumë, ai që humb një mik humb më tepër". Ndoshta me këtë koncept në mendje dhe zemër, poezitë

Poezitë e shumta që kanë për motiv njeriun e kudondodhur shqiptar dhe peizazhin kombëtar në platformën shpirtërore dhe gjeografike, dëshmojnë se ai ka fituar afërsi të reja, si me lexuesin e distancuar, ashtu edhe me ndjekësit besnikë të krijimtarisë së tij

kushtuar Spahiut apo frymëzuar prej tij bëhen pjesë edhe më integrale e konsistente të krijimtarisë së deritanishme të Dibranit. Në 15-vjetorin e vdekjes së Spahiut, pikërisht në vitin 2008, Dibrani investon edhe një herë në ndërrimin e mikut të tij, duke botuar të plotë korrespondencën me të, në një përmblidhje të titulluar "Letrat e Agimit". Ky fakt ka lidhje të ngushta me këtë antologji, sepse sot, pas 20 vjetësh nga vdekja e Agim Spahiut, është pikërisht Mensur Spahiu, vëllai i Agimit, që e vlerëson punën e Dibranit duke sponsorizuar të plotë botimin e librit Anatomia e brymës. Këtë shprehje të mirënjohjes ndaj miqësisë unike të Dibranit me vëllain e tij, Mensuri e bën nën dritën e filozofit Fridrih Niçe, i cili thoshte se "marrëdhëniet tona me njerëzit, nganjëherë e restaurojnë baraspeshën e miqësisë duke hedhur ca kokriza papërshatshmerie (shpenzimi) në anën tonë të kandarit".

EKUILIBRIMI I RAPORTEVE NJERI-SITUATË

Nga një analizë më e thellë e këtij realiteti human dhe poetik, mësojmë se poezitë e librit "Anatomia e brymës" i paraprijnë ruajtjes së njeriut shqiptar edhe nga rreziku i rënies në kurthin e etnocentrizmit. Dibrani është plotësisht i ndërjegjëshëm se njeriu shqiptar beson në origjinin e vet kombëtarë me një prejardhje të përbashkët ilire, ku zakonet sociale dhe besimi fetar kanë ndikuar ndjeshëm në mënyrën e jetesës, si në esencën kulturore kombëtare ashtu edhe në imagjinatën sociale. Ai kësaj pike i jep përparësi si një zotësi kombëtare dhe mundësi për të përfuruar ndarjen e progresit historik nga incidentet fatkeqë të jetës së individit në mërgim. Poezia e tij i inkurajon njerëzit të bëjnë dallime të mençura mes turbulencave personale dhe çështjeve që shtrihen jashtë kontrollit të tyre. Për ta bërë realitet tentativën e ekulibrimit të raporteve njeri-situatë, jetë dhe vrapit e Dibrani ka pësuar modifikimet e domosdoshme. "Anatomia e brymës" dëshmon se retorika e tij është fuqizuar nga përpjekja për të bindur lexuesin me idetë që ofron. Nisur nga kjo nisim konkrete, poetika e tij përkshkruan hapësira kolatike nga eksperimentale tek metafizike e nga mistike tek alegorike vetëm për të sjellë rezonancat emocionale dhe jetësore që gjejmë këtu. Ndaj ndjehem i detyruar ta ritheksoj domosdoshmërinë e trajtimit biografik të kësaj antologjie të rëndësishme poetike. Përndryshe rrezikojmë të mos e shijojmë të plotë faktin se poezia e Shefqet Dibranit ka luajtur një rol kyç në progresin kombëtar të dy-tri dekadave të fundit. (Nga një shkrim më i gjatë)

Poezi

SABILE KEÇMEZI-BASHA

FATAMORGANË

Në shuplakë dore
I mbjellim lulet,
Në shishe mbyllim gjumin,
Shkundemi nga premtimet
Dhe ëndrrat i grisim si letrat,
Se tani kush ka veshë
Kambanat po bien.

Korbat zhveshën lakuriq
As ky filijim nuk bën punë
Për letërnjoftim të ri
Duhet të kemi purpuri diellore.

ISA BAFITAJ

NË RRUGË

Më shikon
e në shikim
eci eci
dhe s'di se ku! ...
Çudi!
Eci ...
dhe zgjoj
vetëm
-bardhësi!
Po tani?!

Tani dritaret e zemrës e ruajnë kujtesën ... në gj.

SHAHBAZE VISHAJ

DITA PA DIELL

Javët i shënjava me vija në mur
Muajt i numërova në gishta
Vitet në rrudhat e ballit
Në burg
Nata ishte pa hënë
E dita pa diell
Vite të tëra
Fola me Ëndërrat dhe muret e ftoht-
ta
Këtu
Kurrë nuk hyri rrezja

ALI M. LAUÇI

ALTERNATIVË

Ata e duan diellin në pranverë
Ai e do diellin në vjeshtë.

Ata epikën nuk e shanë kurrë
Ai jeton me lirikën në kreshtë.

Unë logun e gjinkallës e di
Ai meltin lirikën në mjedis të tij.

IBA TOSKA

PA TITULL

Këndoj. Në klithjet
e fuqishme të jetës
-bardhësi...

Dashuroj. Ngjyrat e
luleve të agut
-nuse

Shikoj. Dritat e
diellit
-kah lindjet